



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 923 / prot.
14

Tiranë më/9.10.2020

VENDIM

Nr. 47, datë 9.10.2020

PËR KONTROLLUESIN “ELITE CONSULTING” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Elite Consulting” SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 138, datë 03.09.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Elite Consulting” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga znj. V.L. në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ka si objekt të veprimtarisë tregtare “Shërbim për mbledhjen e borxheve, Këshillim për Tregjet & Kreditë, Konsulencë Financiare, Konsulencë Fiskale. Ndërmjetësim në shitjen e pronave të paluajtshme. Konsulencë juridike dhe ligjore.”

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “punëmarrës”, “klientë” dhe “vizitorë”. Të dhënat përpunohen manualisht.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, nr. 923/2 prot, datë 04.08.2020, nga shtetasja V. L., në provat e administruara u konstatua se Kontrolluesi ka lidhur, datë 01.12.2018, marrëveshjen “Për mbledhjen e detyrimeve të pa-arkëtuara”, me “Iute Credit Albania” SHA, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, “dhënien e kredive si dhe çdo veprimtari tregtare lidhur me kredidhënien” (në vijim, “Marrëveshja”).

Më datë 20.05.2020, shtetasja V. L. i është dërguar një shkresë nga Kontrolluesi, lidhur me shlyerjen e detyrimit, që shtetasi E. L. (i biri i shtetasjes V.L.), i ka “Iute Credit Albania” SHA. Përpunimi (përdorimi) i të dhënave të ankueses V. L. nuk rezultoi i bazuar në asnjë nga kriteret ligjore të përpunimit, të sanksionuar në nenin 6 të Ligjit.

Gjithashtu, një përpunim i tillë i paligjshëm i të dhënave të shtetasjes V. L. rezultoi në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së të dhënave personale të parashikuar në gjuhën “a” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit.

Për realizimin e Marrëveshjes, rezultoi se “Iute Credit Albania” SHA (në cilësinë e kontrolluesit) ka vënë në dispozicion të Elite Consulting SHPK (në cilësinë e përpunuesit) vetëm të dhënat e debitorit E.L., duke përfshirë: emër, mbiemër, adresën, shumën e kredisë, statusin martesor, të dhënat e pagës dhe emrin e punëdhënësit. Rrjedhimisht, konstatohet se Elite Consulting ka vepruar në kundërshtim me gjuhën “a” të pikës 1 të nenit 20 të Ligjit.

3. Kontrolluesi, nuk ka vendosur “Politika Privatësie” në faqen zyrtare <http://www.eliteconsulting-al.com>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë faqe interneti, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2012 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të Privatësisë” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

4. Nga verifikimi i kryer pranë Zyrës së Komisionerit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka njoftuar Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim, për përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave

që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi disponon Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, por nuk ka parashikuar rregulla specifike mbi mbrojtjen, ruajtjen, përpunimin, dhe sigurinë e të dhënave personale, për të gjitha proceset përpunuese (përpunim për të dhënat personale të klientëve, përpunimin e të dhënave të punonjësve, përpunimi nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), etj.) në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se parashikimi në “Rregulloren specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” i rregullave dhe procedurave organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit video survejimit (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka paraqitur pretendimet me shkrim si më poshtë vijon:

- Nuk janë përpunuar të dhënat e ankueses, pasi shoqëria nuk disponon kapacitete për të kryer proceset përpunuese;
- Debitori E.L. ka deklaruar në formë verbale se njoftimi mund të dërgohet në vendin e punës të nënës së tij, duke ia dorëzuar zarfin më datë 01.06.2020;
- Faqja zyrtare e cila disponohet nga shoqëria është jashtë shërbimit, për shkak se nuk janë paguar tarifat përkatëse;
- Në rregulloren specifike për mbrojtjen, ruajtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale janë parashikuar të gjitha proceset përpunuese.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk e përjashtojnë atë nga përgjegjësia administrative pasi shkeljet e konstatuara, janë serioze dhe çenojnë garantimin e ligjshmërisë në procesin e përpunimit të të dhënave personale.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të Ligjit, të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, sipas përcaktimit në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë”;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 27, 29, 30, 39 (pika 1, gërmat “a”, “b”, “ç” “d” dhe “dh”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20,000 (njëzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 5 dhe 6 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20,000 (njëzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20,000 (njëzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 5, të marrë masat për shkatërrimin e të dhënave të mbledhura në lidhje me shtetasen V.L.

5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, duke vendosur “*Politikën e Privatësisë*” në faqen zyrtare.
6. Kontrolluesi, të depozitojë pranë zyrës së Komisionerit “*Formularin e Njoftimit*” si të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë “*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., për çdo proces përpunimi dhe për çdo subjekt të të dhënave personale;
8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimin e parashikuar në pikën 4 dhe 6;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 5 dhe 7;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
9. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
10. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
11. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 19.10.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

